



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 9, datë 06.09.2023

Për

**“KORRIGJIMIN GABIMEVE MATERIALE NË DOKUMENTIN “RREGULLORE PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE DHE PAJTIMTARËVE TË SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE PUBLIKE” MIRATUAR ME VKD NR.2, DATË 11.03.2021”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

<b>Z. Tomi Frashëri</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Znj. Edlira Dvorani</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Znj. Ketrin Topçiu</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Z. Lorenc Bako</b>	<b>Anëtar</b>

dhe sekretare Znj. Evblina Taçi, në mbledhjen e datës 06.09.2023 sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me vendimin nr.7, datë 16.2.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, me propozim të Drejtorisë së të Drejtave të Përdoruesve dhe Drejtorisë Juridike dhe të Integritetit, shqyrtoi çështjen me objekt:

- *“Korrigjimi i gabimeve materiale në dokumentin “Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, miratuar me VKD nr.2, datë 11.03.2021”.*

**BAZA LIGJORE:**

1. Ligji nr.9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 9918);
2. Ligji nr. 44/2015, datë 30.04.2014 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
3. Rregullore Nr.49, datë 11.03.2021 Për “Mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”.

### **KËSHILLI DREJTUES:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor,

- Dokumenti: *“Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”*;
- Relacioni shoqërues i projektaktit miratues (Relacioni);
- Projektakti miratues i dokumentit (projektvendimi);

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

### **V Ë R E N:**

1. AKEP me Vendimin nr.2, datë 11.03.2021, miratoi dokumentin *“Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”*.
2. Në dokumentin *“Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”* i publikuar dhe në faqen e internetit të AKEP, u konstatuan disa gabime materiale në numërtimin e neneve 29, 40 dhe 41:
  - Numri 29 është përdorur gabimisht për dy nene të njëpasnjëshëm:
    - *Neni 29 E drejta e ankimit të pajtimtarit ;*
    - *Neni 29 Detyrime të ofruesve të shërbimeve për trajtimin e ankesave të pajtimtarit.*
  - *Neni 40 Shfuqizime dhe Neni 41 Hyrja në fuqi* duhet të kenë numrat në vijim 38 dhe 39 repektivisht.
3. Kodi i Procedurave Adminstrative në nenin 112 i njeh organit publik në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, të kryejë korrigjime në gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të korrigjimeve të gabimeve materiale të cituara më lart, bazuar në pikën 1 të nenit 114, pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, dhe nenit 112 të ligjit 44/2015 datë 30.04.2014, Këshilli Drejtues i AKEP;

## **V E N D O S I:**

1. Të miratojë korigjimin e gabimeve materiale në dokumentin "*Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike*", miratuar me VKD nr.2, datë 11.03.2021, si më poshtë:
  - a. Numërtimi i *Neni 29 Detyrime të ofruesve të shërbimeve për trajtimin e ankesave të pajtimtarit*, zëvendësohet me *29/1*
  - b. Numërtimi i *Neni 40 Shfuqizime*, zëvendësohet me *38*
  - c. Numërtimi i *Neni 41 Hyrja në fuqi*, zëvendësohet me *39*.
2. Ky vendim dhe korrigjimet e mësipërme të publikohen në faqen e internetit të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al).
3. Ngarkohet Drejtoria e të Drejtave të Përdoruesve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar**

**Tomi Frashëri**

**Anëtar**

**Edlira Dvorani**

**Anëtar**

**Ketrin Topçiu**

**Anëtar**

**Lorenc Bako**